



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.976/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me apelet e Burhan Muli, Hazir Hyseni, Besim Hyseni, Arianit Beka, Nuhi Fetahu, Sanije Fazliu, Ganimete Fazliu, Fetije Shabani, Murat Shabani, Feta Hyseni, Xhezide Hyseni, Sadik Shabani, Selvije Tërrnava, Isuf Muli, Shkëndije Tërrnava, Ganimete Halili, Flamur Halili, Abdulla Mejzini, Tefik Tërrnava, Qenan Haxhiu, Valbone Haxhiu, Sejdi Halili, Edin Haxhiu, Lela Haxhiu, Nazif Osmani, Taibe Haziri, Igballe Kamberi, Sheremet Rustemi, Sejdi Halili dhe Feride Muli, nga Vushtrria, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullta apelet e apeluesve: Burhan Muli, Hazir Hyseni, Besim Hyseni, Arianit Beka, Nuhi Fetahu, Sanije Fazliu, Ganimete Fazliu, Fetije Shabani, Murat Shabani, Feta Hyseni, Xhezide Hyseni, Sadik Shabani, Selvije Tërrnava, Isuf Muli, Shkëndije Tërrnava, Ganimete Halili, Flamur Halili, Abdulla Mejzini, Tefik Tërrnava, Qenan Haxhiu, Valbone Haxhiu, Sejdi Halili, Edin Haxhiu, Lela Haxhiu, Nazif Osmani, Taibe Haziri, Igballe Kamberi, Sheremet Rustemi, Sejdi Halili dhe Feride Muli, me numër: ZL.Anr.976/2017, ZL.Anr.977/2017, ZL.Anr.978/2017, ZL.Anr.979/2017, ZL.Anr.980/2017, ZL.Anr.981/2017, ZL.Anr.982/2017, ZL.Anr.983/2017, ZL.Anr.984/2017, ZL.Anr.985/2017, ZL.Anr.986/2017, ZL.Anr.987/2017, ZL.Anr.988/2017, ZL.Anr.989/2017, ZL.Anr.990/2017, ZL.Anr.991/2017, ZL.Anr.992/2017, ZL.Anr.993/2017, ZL.Anr.994/2017, ZL.Anr.995/2017, ZL.Anr.996/2017, ZL.Anr.997/2017, ZL.Anr.998/2017, ZL.Anr.999/2017, ZL.Anr.1000/2017, ZL.Anr.1001/2017, ZL.Anr.1002/2017, ZL.Anr.1003/2017, ZL.Anr.1004/2017, ZL.Anr.1005/2017, ZL.Anr.1006/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar apelet e parashtruara nga Burhan Muli, Hazir Hyseni, Besim Hyseni, Arianit Beka, Nuhi Fetahu, Sanije Fazliu, Ganimete Fazliu, Fetije Shabani, Murat Shabani, Feta Hyseni, Xhezide Hyseni, Sadik Shabani, Selvije Tërrnava, Isuf Muli, Shkëndije Tërrnava, Ganimete Halili, Flamur Halili, Abdulla Mejzini, Tefik Tërrnava, Qenan Haxhiu, Valbone Haxhiu, Sejdi Halili, Edin Haxhiu, Lela Haxhiu, Nazif Osmani,

Taibe Haziri, Igballe Kamberi, Sheremet Rustemi, Sejdi Halili dhe Feride Muli, nga Vushtrria, me të cilat theksojnë se ka pasur mungesë të votave për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtri, Taibe Haziri dhe Fitim Halili, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Vushtri.

Paneli nuk u lëshua në vlerësimin e apelit të vëzhguesit nga Vushtrria, nga radhët e subjektit politik PDK, në vendvotimin 2929B/01b, pasi që apeli në apel nuk është cekur emri i apeluesit, dhe apeli si i tillë nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.7, ku përcaktohet: të gjitha apelimet duhet të kenë së paku emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.976/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apelet janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apelet e parashtruara nga ana e apeluesve të lartcekur, janë të parregullta, sepse nuk janë të nënshkruara nga parashtruesit e apeleve dhe si të tilla apelet nuk i plotësojnë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apeleve, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 10.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.976/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyheri Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.